



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:240356
Datë: 11.09.2024
Numri i dokumentit: 06145101

C.nr.3631/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.R. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,745.46 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 11.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.R. nga Prizreni, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, **DETYROHET** e paditura, që paditësit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 18 muaj (për çdo muaj shumën prej 96.97 euro, në shkallë prej 35% të pagës bazë - 459.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), **t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,745.46 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 03.11.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A.R. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate më datë 03.11.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës (AAPARr), në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave

nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën 01.08.2021, deri më 31.01.2023. Padi në paditësi ka theksuar, se është në marrëdhënie pune si mësimdhënës pranë SHMP Qendra e Kompetencës në Prizren, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje në paditësi ka theksuar duke llogaritur periudhën kohore prej 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023 për 18 muaj paditësit i ka takuar e drejta e kompensimit për 35 % të vlerës së pagës në bazë të nivelit të shkollimit e kjo bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe Vendimit të Qeverisë Nr.01/33 dt: 29.08.2008, por që deri më tani në emër të kualifikimit për muaj i është paguar vlera 63.68 euro, e në bazë të përgatitjes profesionale/diplomë, është dashur të paguhet për muaj 160.65 euro, pra paditësit vlera prej 96.97 euro në muaj nuk ju ka paguar fare. Bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar, dhe atë për periudhën kohore 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023, në emër të kualifikimit të pagës mbi pagën bazë me 35% të një page bazë 459 që është e barabartë me 160.65 euro, i është paguara për muaj 63.68 euro, të mbetur obligim për muaj 96.97 duke e shumëzuar për 18 muaj në shumë të përgjithshme prej 1,745.46 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura (AAPARr), në Prishtinë, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në paditësi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Tutje ka theksuar që paditësi nuk ka dëshmuar se ishte anëtar i sindikatës ashtu që parashihet me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, por edhe nëse do të ishte anëtar i sindikatës i njëjti nuk ka dorëzuar ndonjë shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare çka do të thotë se nuk ekzistojnë mundësitë institucionale - financiare dhe bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi kanë kaluar 3 vite të Kontratës kolektive e njëjta më nuk prodhon efekt juridik. Kërkesa e paditësit është mbështetur në Kontratën kolektive për Arsim e dt. 18.04.2017, dhe në bazë të nenit 90 të Ligjit të Punës kohëzgjatja e kësaj kontrate është 3 vite, që nënkupton që tani më e njëjta nuk është në fuqi. E paditura i ka propozuar gjykatës që të veprohet në pajtim me nenin 255 dhe 264 të LOK-së, duku mbështetur në faktin se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara në nenin 387 pika h) duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadia e paditësit respektivisht të hedhet si e palejuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në paditësi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi A.R. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë Qendrës për Kompetencë në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të

ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Nga kontrata e punës nr.8113 të datës 05.10.2020 e lidhur ndërmjet paditësi A.R. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar Master, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin Ekonomik dhe i njëjti ka marrë titullin Master Shkencor në Kontabilitet dhe Auditim, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 506, e datës 13 prill 2021, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Ekonomik, në emër të paditësit. Nga vërtetimi me numër të protokollit 5/200, i datës 30.10.2023, vërtetohet se paditësi A.R. është në marrëdhënie pune në SHMP "Qendra Kompetencës" në Prizren, nga data 03.12.2018, dhe i njëjti vazhdon të punojë si mësimdhënëse pran kësaj shkolle. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 459.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.68 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se "shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që "nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit". Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se "mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që "për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të

përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008", vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t'ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratat e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar paditësit shumën prej 63.68 euro në muaj.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditësit është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 459.00 euro, gjykata vendosi që paditësit i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 459.00 euro apo në shumë prej 96.97 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 96.97 euro, për periudhën kohore prej datës 01.08.2021 deri më datë 31.01.2023 apo për 18 muaj, shumën e përgjithshme prej 1,745.46 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 96.97 euro, duke e shumëzuar për 18 muaj ($18 \times 96.97 = 1,745.46$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 03.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që "po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij".

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e

përgjithshme prej 135.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 31.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3631/2023 të datës 11.09 2024

Gjyqtari,
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.